



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 26.12.2018, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Genc Sherifi, Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rahmani, Fadil Gashi dhe Egzon Azemi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Selim Pacolli, nënkyetari i Komunës, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, përfaqësuesi nga OSCE-ja, dhe përfaqësuesi nga INPO-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta, kryesues**.

Ai tha se kjo është mbledhje e jashtëzakonshme, e thirrur nga Kryetari i Komunës, z. Shpend Ahmeti, me një pikë të rendit të ditës.

REND I DITËS:

- Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Pallati i Rinisë", SHA, në Prishtinë dhe ndërmarrjes "IMN Kosova".**

Selim Pacolli, nënkyetar i Komunës, dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se në mandatin e kaluar nuk kanë qenë të parapara këto dy ndërmarrje të kalojnë në pronësi të Komunës dhe qëllimi ka qenë që, në fund të vitit, mjetet eventualisht që nuk kanë mundur të shpenzohen në drejtori të caktuara nga buxheti i Komunës, e kemi bërë një përbledhje dhe kemi dëshiruar me i paguar obligimet tona të 20 %-it. Kjo është arsyaja që ne e kemi bërë këtë përbledhje të të gjitha fondeve dhe kemi sigurua ato që janë të shkruara në raport, të paguhen dy ndërmarrjet, "Pallati i Rinisë" dhe "IMN Kosova", tjegullorja.

Faqe 1 nga 5

Me çështjen e tjegullores jam marrë shumë, e kemi të premtuar një investim 70 milionë € prej Qeverisë japoneze, për ndërtimin e një Qendre sportive. Janë premtimet e ambasadorit të Japonisë, që kam pasur takime edhe me një përfaqësuesi të tyre që e mbulon sektorin e sportit, këto janë premtimet që më janë dhënë. Jam takuar me punëtorët e fabrikës dhe AKP-në dhe kemi bërë një marrëveshje. Marrëveshja ka qenë që brenda muajve ne t'ia paguajmë shumën prej 4.8 milionë € tjegullores, mirëpo atë projekt marrëveshje ende nuk na e ka dërguar AKP-ja, por brenda ditës pritet të na arrijë dhe sigurisht se do ta keni edhe ju në dispozicion si projekt marrëveshje. Kjo është arsyja që kemi ardhur deri te ky vendim sot.

Halim Halimi shprehu mendimin se këtij vendimi do të duhej bashkëngjitur së paku një arsyetim, se për një shumë kaq të madhe të parasë të vije vetëm një letër kështu, pa e ditur se për çka i ndahet kjo shumë Pallatit të Rinisë, cilat borxhe, kujt i ka borxh etj., do të duhej përcjellë vendimi me një arsyetim.

Sa i përket fabrikë së tjegullave, e dimë çështjen se paguhet 20 % dhe nuk kemi vërejtje. Jemi të lumtur që Pallati i Rinisë i është kthyer Komunës, gjithashtu edhe për fabrikën e tjegullave, por krahas që jemi të lumtur, jemi edhe të zhgënjer, sepse këto para po hiqen prej shpronësimit, prej rrugës mbi lumin Mat, prej ndërtimit të kolektorit të lumbit Prishtina, prej tregut të qytetit, prej Hartës zonale, për të cilën kemi pritur qe 5 vjet dhe me u marrë mjetet dhe me u destinuar për këtë, këto janë vërejtjet. Komuna ka mjaft para që i kanë mbetur dhe kanë me i mbetur shumë para, të cilat nuk mund të realizohen, për shkak se nuk janë kryer projektet e parapara të Komunës.

Eman Rahmani theksoi se qysh në fillim nënkyetari tregon se kjo qeverisje është duke sjellë një plan, ku thotë që kemi pritur deri në fund të vitit me pa a po shpenzohen a jo mjetet, për me iu dhënë 20% punëtorëve, e që është dashur në fillim të bëhet planifikimi, ku as për vitin e ardhshëm nuk është planifikuar në buxhet dhe në kornizë afatmesme, dhe kjo i ka dy arsy pse ka vepruar kështu: sepse ekzekutivi nuk ka arritur me i shpenzuar dhe me i përfunduar projektet, si p.sh. Tregu i qytetit, që është një nevojë e jashtëzakonshme, e cila për një shumë 180.000 €, kam kërkuar nga nënkyetari, qe tre muaj nuk kam marr përgjigje nga drejtoresha e Financave, nga drejtori i Investimeve Kapitale dhe nga askush nuk kam marrë përgjigje. Këtu është duke u qeverisur sikur ta kishin pronë private, nuk është duke u qeverisur mirë për qytetarë, me u hequr 6 milionë € prej investimeve kapitale me dy fletë shpjegime, kjo është e papranueshme!

Sa i përket Pallatit të Rinisë, ka qenë premtim se kur t'i kthehet Komunës do të bëhet një plan aksional, ku do të dihet çka do të bëhet, si do të investohet. Përveç mostransparencës gjatë transferimit nga AKP te Komuna e Prishtinës, nuk na është dhënë asnjë informatë si ka qenë marrëveshja Komunë - AKP, e neve si asamblistë na vije në Kuvend të votojmë e të kalojë. Sa i përket "IMN Kosova", në parim e mbështesim, se ata punëtorë e presin 20%-shin qe sa vite dhe duhet me ua dhënë ato mjete se iu takojnë, mirëpo, fatkeqësisht, janë projekte me mjete të marra, duhet të bëhet një planifikim se kur dhe si do t'u jepen këto mjete këtyre ish-punëtorëve.

Fadil Gashi tha se për këto mjete që po jepen për Pallatin e Rinisë, duhet pasur disa arsyë shtesë.

Selim Pacolli dha sqarime, duke cekur se duhet paguar punëtorët, sepse është obligim dhe janë 3.7 milionë € të cilat i trashëgojmë ne prej një padie gjyqësore që pati ndodhur një djegie, që ne e kemi pranuar si obligim vetëm për me ardhur deri te pronësia e Pallatit të Rinisë.

Sami Boroci tha se ne si grup do ta përkrahim këtë pikë. Sa i përket "IMN Kosova", çështja është e çartë, i kemi pasur edhe protestat e punëtorëve, është mirë që është trajtuar kjo çështje. Sa i përket Pallatit të Rinisë, do të duhej që këto gjëra me u sqarua edhe para këshilltarëve të tjerë komunalë, se p.sh. kurë e kemi votuar Sport Marketingun në seancën e kaluar, që e kemi ditur se e kemi marrë prej një kategorie tjetër buxhetore e këtu kemi të bëjmë me largimin e projekteve kapitale, kështu që për Kuvend të kemi sqarime më të mëdha për këtë 3 milion €. Sa i përket asaj që e tha Emani, që është duke qeverisur si pronë private, mendoj se kjo nuk ka të bëjë me pronën private, mirëpo qytetarët e Prishtinës votuan një qeverisje që është përgjegjëse për qeverisjen e Prishtinës për 4 vjet.

Agim Gashi tha se arsyja pse ne do ta votojmë Vendimin, është se ajo është pronë ndoshta 100 herë më e madhe se obligimi që na vjen nga ajo, edhe pse kjo nuk është obligim, për shkak se edhe ne duhet të gjykojmë drejt, sa kemi të drejtë që kontributin ta japim në këtë mënyrë te qytetarët dhe të luftojmë për ta, për arsy se shumë vite është thënë se Komuna nuk po ka mjete me mbuluar vlerën e projekteve të mëdha, siç është rruga "A", e kur po e analizojmë këtu, po del që për 2 vjet në vite buxhetore, rrreth 3 milionë € nuk janë shpenzuar, që janë planifikuar për rrugë "A", e tash po barten për një projekt tjetër. Kjo është ajo që unë e shoh se qeverisja komunale është dashtë paraprakisht para se të nënshkruhet marrëveshja me AKP-në, me ardhur në Kuvend dhe me na treguar se e kanë një ofertë, për të cilën Komuna ka qenë e interesuar qe 10 vjet, për kthimin e atyre pronave, pse nuk kanë gjetur mirëkuptim me Qeverinë, ajo është çështje tjetër. Nuk është kërkësë e sotme, është e kamotshme, mirë që është gjetur mirëkuptimi dhe janë dakorduar që ato dy prona me iu kthyer Komunës së Prishtinës.

Egzon Azemi tha se kjo qeverisje është një qeverisje Ad hoc, që nuk ka kurrfarë plani afatgjatë se çka me punuar, por të gjitha vendimet i merr momentale dhe prandaj bëhen këto tema problematike. Në vend se ne me u gëzuar, ka shumë dyshime se çka është duke bërë, pse është duke bërë, e mira e saj është që edhe një herë po dëshmohet se protestat janë rruga më e mirë për me u kthyer vëmendjen dhe me i fituar të drejtat e veta qytetarët, pasi që erdhën dy herë këtu rrreth 200 punëtorë, por sot po e fitojnë të drejtën. Kjo rrugë është që me iu dhënë si informacion sa më shumë qytetarëve dhe grupeve të tjera, sepse e vetmja mënyrë për me ecur punët në Komunën e Prishtinës është kjo, që është mjet shumë i mirë. Megjithatë, kemi shpresuar me këtë qeverisje, nuk është dashtë me qenë kjo mënyrë, ndoshta ish dashur vetëm kërkesa me qenë e jo edhe protesta.

Tjetra, është se mossinqeriteti i ekzekutivit në seancën e Kuvendit, ku kanë qenë dy pika për fillimin e Planit të hollësishëm rregullues, unë propozova me e tërhequr atë Plan dhe thash që keni premtuar që në qershori të vitit 2019 përfundon Harta zonale. Thash se nëse nuk

përfundon Harta zonale nuk po i tërheqim, por po i lëmë kështu, Genci tha përfundon, e pastaj pas një jave na erdh Vendimi që mjetet e ndara për Hartë zonale tërhiqen. Ne si grup do ta votojmë këtë Vendim, por nuk është kjo mënyra se si është dashur me u qeverisur Prishtina në vitin 2018.

Selim Pacolli iu drejtua Egzonit, duke i thënë se kur flisni për protestat, faktikisht duhet me ditur se Komuna nuk ka qenë adresë e protestave. Kur kanë ardhur punëtorët e tjegullores në protesta, ne kemi qenë në seancë të Kuvendit, kam dalë dhe jam takuar, i kam marrë 3 - 4 përfaqësues, kam biseduar me ta dhe kam arritur që brenda 40 ditësh me bërë marrëveshje me AKP-në, që mos me u endur punëtorët. Nga ana ime përpinqem të jem transparent dha atë që e bëjë e bëj shumë haptas dhe besoj që ia vlen një investim i tillë.

Egzon Azemi iu përgjigj, duke thënë se ne po të kuptojmë si po thua këtu, por është mirë në Kuvend me thënë, e kemi një premtim nga një ambasador se kanë me investuar, nuk e di sigurte se vërtetë është duke investuar.

Selim Pacolli tha se është një ambasador i një shteti që është serioz, që premton gjëra të tilla dhe rrinë prapa tyre.

Agim Gashi theksoi se nuk mundet askush të më bind se Qeveria japoneze i ka premtuar 70 milionë € investime, ky është një premtim në ajër. Ne e patëm proceduar në atë kohë për autobusët dhe Qeveria japoneze na e pati kthyer përgjigjen negative dhe asnjëherë nuk kemi thënë se na kanë premtuar. Tash ka negociata se ka interes, se po kthehen dy prona të Komunës, se çka do të investohet do ta shohim më vonë. Pakënaqësia jonë është për shkak të procedurave dhe mospërfilljes së përgjegjësive dhe kompetencave që i kanë njerëzit brenda institucionit.

Vala Peshku tha se rastet kur një nënkyrjetar ka lidhje të drejtpërdrejta me një ambasador të një shteti mik dhe kur flitet për miliona investime, unë besoj se nuk është çështje e jona me diskutua a është e vërtetë a jo. Po ashtu, tha se jemi duke diskutuar për dy ndërmarrje publike, ku Pallati i Rinisë është ndërtuar prej prindërve tanë. Unë kam informata pak pse jonë marrë këto fonde prej këtyre linjave buxhetore. Mua më ka interesua më së shumti për 2 milionëshin që është marrë prej ndërtimit të Fabrikës së Ujit në Shkabaj, ku sipas të gjitha gjasave janë mjete që barten qe 2 vjet dhe nuk ka raport që kanë me u shpenzuar. Edhe rruga mbi lumin Mat nuk mundet me vazhduar pa u kryer kolektori, andaj sa rrinë këto mjetet kot dhe vetëm barten, më mirë është me e zgjidhur çështjen e Pallatit të Rinisë, sepse është pronë publike.

Valbona Makolli dha sqarime, duke cekur se është konsultuar me drejtorë, p.sh. tek shpronësimet janë vlerat më të mëdha që duhet me u shpronësuar sesa ne që kemi mjete në dispozicion, këto pjesët tjera janë për shkak të shpronësimeve, janë çështje me prona. Ndërsa Egzonit iu përgjigj, duke thënë se hartimi i Hartës zonale nuk është tërhequr prej projektit. Edhe projektet tjera që janë këtu me bartje të lirë, prapë kemi me i diskutuar bashkë këtu, se këto nuk janë tërhequr dhe nuk mundemi me i tërhequr.

Agim Gashi pyeti drejtoreshën se a i kanë paguar rrogat e punëtorëve të Pallatit të Rinisë në muajin e kaluar me mjete të Komunës.

Valbona Makolli theksoi se ato mjete që kanë qenë në AKP, kanë kaluar në xhirollogarinë e Pallatit të Rinisë, kështu që është dashur me hapur një xhirollogari të veçantë dhe në momentin që i kanë qitur mjetet e kanë bërë pagesën.

Kryesuesi e hodhi në votim **Propozimvendimin** për ndarjen e mjetave ndërmarrjes publike lokale “**Pallati i Rinisë**”, SHA, në Prishtinë dhe ndërmarrjes “**IMN Kosova**”.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndarjen e mjetave ndërmarrjes publike lokale “**Pallati i Rinisë**”, SHA, në Prishtinë dhe ndërmarrjes “**IMN Kosova**” dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

Procesmbajtësja
Shykrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta

